



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 77 datë 23.09. 2025

**PËR MBLEDHJEN E DETYRIMEVE TATIMORE VJETORE DHE DETYRIMEVE
TË PRAPAMBETURATË SUBJEKTEVE DEBITORË, ME AGJENTIN TATIMOR
SHOQËRINË E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE GJIROKASTËR.**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurta Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimi nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurta Tatimore ", kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor" dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të bëhet mbledhja e detyrimeve tatimore vjetore dhe detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë, me Agjentin Tatimor Shoqërinë e Ujësjiellës Kanalizimeve Gjirokastrë.
2. Kryetari i Bashkisë të nënshkruaj Akt – Marrvëshje me Shoqërinë e Ujësjiellës Kanalizimeve Gjirokastrë, për hapat që do të ndiqen për mbledhjen e detyrimit Tatimor.
3. Detyrimi i Vitit 2025, do të faturohet në faturën e muajit aktual pas konfirmimit të vendimit në Prefekturën Gjirokastrë, sipas listave bashklidhur.
4. Detyrimet e prapambetura do të ndahen me këste për likuidim sipas akt-marrvëshjeve me subjektet debitorë sipas listave bashklidhur.
5. Në rastin kur subjekti nuk paraqitet për lidhjen e akt-marrvëshjes me këste, për detyrimin tatimor, nga ana e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik do të aplikohet vet ndarja me këste deri në shlyerjen e vlerës së detyrimit, në të njëjtën mënyrë si dhe për subjektet që do të lidhin Akt-Marrvëshje.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Taksave, Aseteve dhe licencave .
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI